REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 976/20
Datë/Datum. 25.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*
Dior Halili	***23/11/2020***	***25/11/2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.11.2020, **OE "Albo Group"SH.P.K & "Ekovizioni" – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me **nr: 976/20** kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"253-20-6620-2-3-6"**, respektivisht atij me titull **"Hartimi i Strategjisë së AMKMK – së"**, iniciuar nga **AK – AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë: kutoim i cmimit, lloji i kontratës: shërbime, ndarja në pjesë: jo, vlera e parashikuar e kontratës: 9,999.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.
Njoftimi për kontratë: 20.10.2020
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 26.10.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 03.11.2020
Ankesa për rishqyrtim në AK: 06.11.2020
Njoftimi mbi pezullimi e aktivitetit nga AK:06.11.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-së pas rishqyrtimit: 11.11.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Me datën: 19.11.2020, **OE "Albo Group"SH.P.K & "Ekovizioni" – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me **nr: 976/20** kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"253-20-6620-2-3-6"**, respektivisht atij me titull **"Hartimi i Strategjisë së AMKMK – së"**, iniciuar nga **AK – AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK).**

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 44.5 i RRUOPP-së

OE ankues është njoftuar me letrën standarde për tenderues të eliminuar me dt.03.11.2020 lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa e keni anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se nuk ka asnjë OE të përgjegjshëm.

Arsyeja e eliminimit tonë e cekuar nga AK: "Është i papërgjegjshëm sepse ka prezantuar vetëm një referencë të natyrës së ngjashme, ndërsa janë kërkuar dy si dhe nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet (të prezantoj certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime në organizimin e moduleve të trajnimit).
Kjo nuk qëndron sepse ne si konzercium kemi mbi dhjetë kontrata të natyrës së ngjashme ku kemi dëshmuar me referenca, si:

1. "Hartimi i strategjisë zhvillimore lokale të turizmit 2020-2024 në komunën e Skenderajt"
2. "Organizimi i punëtorive për rishikimin të strategjisë së "Rrjetit të Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës"
3. "Mbështetja teknike për hartimin e planit të menaxhimit të Parkut Gërmia"
4. "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile dhe qytetareve në mbrojtje të mjedisit në nivel lokal" (ku kemi hartuar dy rregullore për komunën e Podujevës: 1. Rregulloren për Mbrojtje të Mjedisit dhe 2. Rregulloren për Menaxhim të Mbeturinave).

Po ashtu kemi prezantuar edhe certifikata për trajnime të menaxherit të projektit si dhe një CV të begatshme, ku në pozitën e zyrtarit ligjor në komunën e Podujevës, ka mbi 15 vite eksperiencë pune, si konsulet ligjor në Ekovizion (4 vite) dhe një vit në Albo Group duke punuar në strategji dhe rregullore të ndryshme.

Menaxheri i proejktit ka edhe tetë certifikata për traqjnime të ndryshme në fushën e juridike, të cilat i kemi prezantuar në ofertën të dorëzuara në AK. Asnjëra nga arsyet e cekura të AK nuk qëndron. Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Ankesën tonë në mënyrë meritore dhe të nxjerrin vendim:

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Albo Group" SH.P.K & "Ekovizioni"

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: *Arysetimi i AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues.*

ARSYETIM *[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :

Është i papërgjegjshëm sepse ka prezantuar vetëm një reference te natyrës se ngjashme udërsa janë kërkua dy si dhe nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet (te prezantoj certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime ne organizimin dhe zhvillimin e moduleve te trajnimit)

Ju informojmë se ne baze te nenit 44,paragrafi 44.5,piku (ii) te RRUOPP-se anulohet ky AP dhe do te perseritet.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

BesimMulaj _____ _____

(Nënshkrimi)

Fakt 2: *Kërkesat e paraqitura nga AK të natyrës ekonomike & financiare dhe teknike & profesionale dhe dështmitë e kërkuara dokumentare.*

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;	**Evidenca 1 Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
Operatori ekonomik duhet te ofroj dështmi Autoritetit Kontraktues për qarkullimin financiar të realizuara në tri vitet e shkuara ka qenë jo me pak se 15,000.00 €.	**Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo raport nga banka.**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dështmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës së ngjashme (në hartimin dhe analizimin e legjislacionit, të ketë përvojë në hartimin e akteve strategjike strategjive, vendimeve dhe opinioneve ligjore, të kenë njohuri për legjislacionin për administratën publike, legjislacionin për zyrtarët publik si dhe legjislacionin për AMKMK-në, të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë , se paku dy (2) referenca . Kërkesa 2. OE duhet të prezantoj stafin Professional dhe menaxherial • Një menaxher të projektit, të cilët duhet të ketë diplome universitare , me përvojë 7 vjeçare të kenë përfunduar trajnime për hartimin e legjislacionit, të kenë të përfunduar trajnimin për organizimin dhe zhvillimin e moduleve të trajnimit etj.	**Evidenca 1. Listën e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë, duhet të dorëzohet ne origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe te bashkëngjiten si dështmi edhe referenca ose pranimi teknik . Evidenca 2 Dështmi për stafin profesional dhe menaxherial • Vendim me shkrim mbi caktimin e një menaxheri te projektit i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne origjinal • Dështmitë për menaxher te projektit Kopja e diplomës , CV-it ,te prezantoj certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime ne organizimin dhe zhvillimin e moduleve te trajnimit , kopja e kontratës së punës apo marrëveshje për ketë projekt**

Fakt 3:*Lista e kontratave të realizuara të OE ankues, gjegjësisht Albo Group, dhe më pas kontratat referencë*

të Ekovizionit, partnerit biznesor në konzorciumin ankues.

Lista e kontratave te realizuara

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Numri i telefonit te Blerësit
1	Fushata vetëdijesuese për shfrytëzimin e transportit publik	04.10.2019	04.05.2020	4,948.00 €	Komuna e Prishtinës	prokurimi.prishtine@rks-gov.net	038 230 900
2	Organizimi i punëtorive lidhur me informimin akterëve me interes për kriteret e efiçiencës së energjisë në ndërtesa.	13.12.2019	13.03.2020	1,997.00 €	Komuna e Prishtinës	prokurimi.prishtine@rks-gov.net	038 230 900
3.	Organizimi i punëtorive për rishikimin të strategjisë së "Rrjetit të Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës"	18.12.2019	04.03.2020	1,290.00 €	NORDK	nordk@gmail.com	+383 44 652 651
4.	Raporti për kënaqësinë e konsumatorëve	20.03.2020	27.03.2020	477.90 €	Kompania për menaxhimin e Deponive – KMDK sh.a.	klmemehmettinova@gmail.com	+383 44 130 028
5.	"Hartimi i strategjisë zhvillimore lokale të turizmit 2020-2024 në komunën e Skenderaj"	06.05.2020	02.09.2020	6,985.60	Komuna Skenderaj	prokurimi.skenderaj@rks-gov.net	

Gjithsej: 15,699.5 EUR

Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Numri i telefonit te Blerësit
1	Fushatë vetëdijesuese për shfrytëzimin e Transportit publik	25.07.2016	05.06.2017	4,889.00 €	Komuna e Prishtinës	prokurimi.prishtine@rks-gov.net	038 230 900
2	"Përgatitja dhe zhvillimi i fushatës së vetëdijesimit, informimit dhe edukimit me fushën e ndarjes se mbeturinave ne burim"	21.12.2016	20.12.2017	34,839.33€	Komuna e Prishtinës	prokurimi.prishtine@rks-gov.net	038 230 900
3	Fuqizimi i rinisë përmes ngritës së kapaciteteve të tyre	05.04.2017	30.06.2017	2,620.00 €	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	burim.mexhuani@rks-gov.net	038 20022526
4	Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për menaxhimin e mbetarinave në Komunën e Prizrenit	26.04.2017	15.12.2017	5,988.00 €	Komuna e Prizrenit	prokurimipz@hotmail.com	038 20044704
5	"Ambienti për të gjithë"	01.06.2017	30.01.2018	11,919.60€	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)	office@kcsfoundation.org	038 600 633

6	"Menaxhimi i mbetjeve mjekësore"	02.10.2017	30.09.2018	29,904.92€	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Civile (KCSF)	office@kcsfoundation.org	038 600 633
7	"Mendo Gjelbër"	16.02.2018	30.06.2018	7,000.00 €	Agjencia Austriake e Bashkëpunimit (ADA) dhe Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Juglindore (REC)	gvdullahu@gmail.com	038 225123
8	"Manifestimi i ditëve ndërkombëtare mjedisore sipas kalendarit mjedisor"	30.04.2018	30.09.2018	3,878.00 €	Komuna e Prishtinës	prokurimi.prishtine@rks-gov.net	038 230 900
9	"Zhvillimi i Shkathtësive të Buta për të rinj"	18.07.2018	18.10.2018	7.535.00€	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	burim.mexhuani@rks-gov.net	038 20022526
10	"Fuqizimi i OSHC-ve lokale dhe qytetarëve në parandalimin e korrupsionit në prokurimet publike komunale"	01.08.2018	31.03.2020	8,550.00 €	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)	info@kdi-kosova.org	038 248 038
11.	Plani lokal i veprimit në Biodiversitet & Mjedis" për komunën e Gjakovës	01.09.2018	20.02.2019	2,000.00 €	Qendra Rajonale e Mjedisit - Zyra Kosovë (REC KOSOVO)	anishori@rec.org	038 225123
12	"Ngritja e kapaciteteve e të rinjve përmes zhvillimit i Shkathtësive të Buta"	09.10.2018	28.02.2019	6,000.00 €	Ministria e Punës dhe Mirëqenjës Sociale	gani.smakaj@rks-gov.net	038 212 504
13	"Ambienti për të gjithë 2.0"	01.01.2019	30.06.2019	6,000.00 €	Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS)	info@iksceb.org	038 260 600
14	"Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në mbrojtje të mjedisit në nivel lokal"	01.03.2019	30.07.2019	4,000.00 €	Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ)	kushtrim.puka@fiq-fci.org	038 610 677
15	"Raporti për kërkesën e konsumatorëve"	14.03.2019	21.032019	938.10 €	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	klmemehmettinova@gmail.com	044 130 028
16.	"Trajnime profesionale me përpunësi me tregun e punës"	17.04.2019	17.08.2019	12,540.00 €	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	burim.mexhuani@rks-gov.net	038 20022526
17.	"Mendo Gjelbër"	28.05.2019	20.12.2019	4,000.00 €	Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	zpek@president-kgov.net	038 211 975
18.	"Mbeshtetje teknike për hartimin planit të menaxhimit të parkut Germia"	02.07.2019	01.10.2019	24,970.00 €	Komuna e Prishtinës	prokurimi.prishtine@rks-gov.net	038 230 900
19.	"Live green, Save Green"	03.07.2019	02.03.2020	4,000.00 €	Balkan Green Foundation	grants@balkangreenfoundation.org	049 728 019
20.	"Menaxhim i mirëfëllë i mbetjeve jetë e shëndetshme"	03.07.2019	02.03.2020	5,999.50 €	UNDP	Maria.suokko@undp.org	038 249 066
21.	"Edukim mjedisor për zhvillim të qëndrueshëm"	08.09.2019	08.12.2019	5,100.00 €	"Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor"	Besmir.Kokollari@rks-gov.net	044659662
22.	"Projekti për mbeshtetjen e të rinjve nga familjet që marrin asistencë sociale të kategorisë së II-te per zhvillimin e shkathtësive per punë ne tregun e punës në komunën e Prishtinës, Podujevës dhe Vushtrrisë"	01.11.2019	28.02.2020	5,000.00 €	Ministria e Punës dhe Mirëqenjës Sociale	gani.smakaj@rks-gov.net	038 212 504
23.	"Ekonomi e gjelbër për zhvillim të qëndrueshëm"	25.06.2020	25.10.2020	3,500.00 €	NORDK	Nordk.kosovo@gmail.com	+383 (0) 45 652 651
24.	"Program trajnimi profesional për të rinjtë e pa punë"	02.07.2020	30.10.2020	14,000.00 €	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	burim.mexhuani@rks-gov.net	038 20022526

Total: 215,171.50 EUR

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik

Vula _____

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Kontraktues ku thuhet që OE ankues është i papërgjegjshëm sepse ka prezantuar vetëm një referencë të natyrës së ngjashme, ndërsa janë kërkuar dy si dhe nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet (të prezantojë certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime në organizimin e moduleve të trajnimit), Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të listës së kontratave dhe dëshmive dokumentare të dorëzuara nga OE ankues, gjen pretendimin ankimor si pjesërisht të pabazuar. Arsyetimi vijon si më tutje:

- Për faktin që kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar që OE të ofertojë kontrata të natyrës së ngjajshme me fushëveprim si në vijim: hartimin dhe analizimin e legjislacionit, përvojën në hartimin e akteve strategjike strategjive, vendimeve dhe opinioneve ligjore, njohuri për legjislacionin për administratën publike, legjislacionin për zyrtarët publik si dhe legjislacionin për AMKMK-në, Eksperti vlerëson që kontrat e prezantuara si referencë të OE ankues, gjegjësisht vlerësimi i fushëveprimit të tyre duhet dekompozuar në termet e referencave për më në detaje për të parë nëse këto të fundit përkojnë me cka është kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit. Konform dispozitave ligjore në fuqi të shënuara edhe në RRUOPP, mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues që ky i fundit mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së.
- Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 29 kontrata (5 nga Albo Group dhe 24 nga partneri i tyre i konzorciumit Ekovizioni – shih faktin me numër 3) të cilat janë të shënuar si referencë e që kanë natyrë të ngjajshme apo të njejtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nese përmbajtja (shërbimet e kryera në këtë rast) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Kontraktues ku thuhet që OE ankues është i papërgjegjshëm sepse nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet relevante ku konform kërkesës së shënuar në FDTdhe në Njoftim për Kontratë është dashur të ofrojë certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit sikurse edhe atyre të natyrës së zhvillimit të moduleve të trajnimit, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dërguar nga OE ankues e gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar. Përderisa përgatitja akademike e Menaxherit të Projektit përcaktuar nga OE ankues përkon me fushëveprimin e aktivitetit marrë parasysh natyrën juridike në thelb të këtij të fundit, ceritifikatat për trajnime dhe hartim të legjislacionit janë më gjithëpërfshirëse për nga ana teknike. Si të tilla, mbetet nën përgjegjësinë e AK-së që këto certifikata së bashku me referencat për projektet e mbikëqyrura të vlerësohen më në detaje për nga fushëveprimi i tyre, dhe të vlerësohen nëse bashkërendojnë me kërkesat e paraqitura në FDT dhe Njoftim për Kontratë konform nenit 72 të LPP-së.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër "253-20-6620-2-3-6", respektivisht atij me titull "Hartimi i Strategjisë së AMKMK – së", iniciuar nga AK – AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK), të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK)**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **"Albo Group"SH.P.K & "Ekovizioni" – Prishtinë,**